



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1001/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Milena Gjeriq e Valon Totaj anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen jokontestimore të propozuesit A.T nga Komuna Kaçanik, të cilin me autorizim e përfaqëson F. T avokat në Kaçanik, kundër kundër propozueses Qeveria e Kosovës (Organi Shpronësues) MMPH Prishtinë, me seli në Prishtinë, për caktimin e kompensimit për pasurinë e shpronësuar dhe kompensimin e dëmit për pjesën e mbetur jashtëshpronësimit, vlera e kontestit 10,924.00€, duke vendosur sipas ankesës së kundërpropozuesit, e paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik CN.nr. 151/17 të datës 20.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 08.02.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e kundër propozueses Qeveria e Kosovës (Organi Shpronësues) MMPH Prishtinë, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik CN.nr. 151/17 i datës 20.01.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit, miratohet në tërësi si i bazuar propozimi i propozuesit A. T nga Komuna e Kaçanikut dhe caktohet kompensimi në shumë 10,924.00€, në emër të vlerës financiare-diferencës për pjesën e shpronësuar dhe në emër të vlerës financiare-dëmit të pësuar për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit për ngastrën kadastrale me nr..., të evidentuara në çertifikatën e pronës me nr. të lëndës ... edhe atë: në emër të vlerës financiare-diferencës për pjesën e shpronësuar të ngastrës kadastrale pk.nr..., në sipërfaqe prej $1654\text{m}^2 \times 3.00\text{€}/\text{m}^2 =$ në shumë 4,962.00€. Në emër të vlerës financiare-dëmit të pësuar për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit të ngastrës kadastrale pk.nr..., në sipërfaqe prej $8517\text{m}^2 \times 7.00\text{€}/\text{m}^2 = 59,619.00\text{€} \times 10\% = 5,962.00\text{€}$. Në pikën II., të dispozitivit urdhërohet kundërpropozuesi-Organi Shpronësues Republika e Kosovës Qeveria e Kosovës që propozuesit A. T nga Komuna e Kaçanikut, t'ia kompensoj shumën prej 10,924.00€, këtë shumë me

kamatë prej 7% duke filluar nga data 27.10.2017 e deri në pagesën definitive. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet kundërpropozuesi që propozuesit t'ia paguaj shumën si në pikën II, të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës jokontestimore në shumë prej 1098.00€, këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit në dorëzim të aktvendimit, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë pala kundërpropozuese, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktvendimi i atakuar, të refuzohet propozimi i propozuesit duke lënë në fuqi Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.11/10 i datës 27.10.2017 dhe të vërtetohet se vlerësimi i dhënë në Raportin e Vlerësimit është bërë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Pala propozuese ka parashtruar përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e kundërpropozueses, ndërsa aktvendimi i atakuar të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimi i atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi A. T ka parashtruar propozim për caktimin e kompensimit për pasurinë e shpronësuar dhe kompensimin e dëmit për pjesën e mbetur jashtëshpronësimit, ndaj kundërpropozuese Qeveria e Republikës së Kosovës, me të cilën ka kërkuar që t'i caktohet kompensimi propozuesit për eksproprijim të pjesëve të parcelave kadastrale: ... me sipërfaqe që shpronësohet 1654m² dhe pjesë e mbetur jashtë shpronësimit në sipërfaqe prej 8517m² ZK Komuna e Kaçanikut. Të detyrohet kundërpropozuesja që propozuesit t'ia bëjë kompensimin e parcelës me nr. ... sipërfaqe 1654m², shumën financiare të diferencuar prej 4,962.00€. Për zvogëlimin e vlerës së paluajtshmërisë së mbetur jashtë shpronësimit sipërfaqe prej 8517m² në shumë prej 5,962.40€. gjithsej totali 10,924.00€ me kamatë vjetore prej 7% nga data 30.06.2017, atëherë kur ka hy në fuqi vendimi përfundimtar si dhe shpenzimet be procedurës jokontestimore.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: aktvendimi përfundimtar nr.11/10 i datës 27.10.2017, akt vlerësimi për parcelën ..., certifikata e pronës, raporti i vlerësimit, aktvendimi për trashëgimi dhe plotësimi i bërë në seancë.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paluajtshmëria e shpronësuar evidentohet në emër të propozuesit, është shpronësuar për interes publik, palët në procedurën e shpronësimit nuk kanë mundur të arrijnë marrëveshje për kompensim. Kompensimi i caktuar nga Organi Shpronësues nuk është bërë në bazë të vlerës së tregut, ndërsa vlera reale e paluajtshmërisë së shpronësuar është vlerësuar nga ana e ekspertit vlerësues. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se me rastin e shpronësimit pjesës së paluajtshmërisë të mbetur jashtë shpronësimit i ka humbur vlera.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 319.1 i LPK-së: “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nga gjendja e vërtetuar faktike kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktvendim i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të tillë dhe këtë e ka bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje juridike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaftueshëm i qartë e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimin, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesës së parashtruar me propozim dhe në lidhshmëri me këtë, ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sa i përket bazës për kompensim, kolegji gjen se, për rastin konkret është kryer edhe ekspertimi i nevojshëm, dhe në shkresat e lëndës gjendet ekspertiza e ekspertit vlerësues që e dokumenton një gjë të tillë. Nga shkresat e lëndës kolegji gjen se Qeveria e Kosovës ka bërë shpronësimin e paluajtshmërisë së propozuesit për interes publik. Ndërsa nga ekspertiza e ekspertit vlerësues A. S është vërtetuar se vlera totale e sipërfaqes së shpronësuar prej 1654m² është 11,578.00€, ndërsa vlera e humbur për pjesën e sipërfaqes së ngastrës nr... të pa shpronësuar në sipërfaqe prej 8517m² është 5,962.00€. Lidhur me ekspertimin e kryer nga eksperti vlerësues, kolegji e ka vlerësuar si të rregullt dhe profesionale dhe e njëjta i përmbushë konditat e nevojshme për marrjen e provës sipas saj. Në anën tjetër kolegji ka gjetur se kundërpropozuesja përveç kontestimeve verbale, nuk ka propozuar plotësim të ekspertimit ekzistues apo nxjerrje të ndonjë ekspertimi tjetër, që do të argumentonte një gjendje tjetër nga mendimi ekzistues i ekspertit vlerësues.

Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë ka vlerësuar se pala kundërpropozuese nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1001/20, me datë 08.02.2020

Kryetari i kolegjit - gjykatësi

Dr.sc. Rafet Haxhaj